



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria / Vlada / Government

MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE

KKRF- KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR
KSFI – KOSOVSKI SAVET ZA FINANSIJSKO IZVEŠTAVANJE
KCFR – KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.2015/01

PËR LICENSIMIN E AUDITORËVE LIGJOR

Ligji Nr. 04/L-014 i jep Këshillit autoritetin të vendos regjimin për raportimin financiar të organizatave biznese në Kosovë, përfshirë certifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e auditorëve.

Gjatë implementimit të dispozitave të Ligji Nr. 04/L-014, Këshilli vështron standardet e aplikueshme ndërkombëtare, udhëzuesit dhe interpretimet dhe përafron praktikën në Kosovë me Direktivat relevante 4, 7 dhe 8 të Ligjit Evropian të kompanive dhe direktiva 2014/56 e BE “Mbi auditimet ligjore të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara financiare” .

Direktiva 2014/56 e BE “Mbi auditimet ligjore të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara financiare” dhe Standardi 8 Ndërkombëtar i Edukimit “Kërkesat për kompetencë për profesionistët e auditimit” të publikuara nga Bordi për Standardet Ndërkombëtare të Edukimit për Kontabilitet (BSNEK – IAESB) janë të një rëndësie të veçantë për qëllimin e këtij udhëzimi administrativ.

Ky udhëzim administrativ përcakton kërkesat të cilat duhet t'i plotësojnë aplikuesit në mënyrë që të pajisen me certifikatën e praktikës si auditor ligjor. Ky udhëzim administrativ, zëvendëson udhëzimin administrativ ekzistues në vijim:

